

Në bazë të nenit 25 dhe 47 paragrafi 1 pika 6 nga Ligji për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

**VENDIM PËR TËRHEQJEN NGA QARKULLIMI TË KARTËMONEDHAVE ME
VLERË NOMINALE 10 DHE 50 DENARË**

1. Kartëmonedhat me vlerë nominale 10 dhe 50 denarë, të cilat janë në qarkullim nga data 8 shtator i vitit 1996, të emetuara në bazë të Vendimit për emetim, vlerë nominale dhe karakteristika themelore të kartëmonedhave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 45/96) dhe Vendimit për emetimin e kartëmonedhave me vlerë nominale 10, 50 dhe 100 denarë, me karakteristika të ndryshuara ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 04/01), tërhiqen nga qarkullimi, duke duke i këmbyer ato falas me kartëmonedha dhe monedha të tjera në shumë ekuivalente.

2. Kartëmonedhat nga paragrafi 1 i këtij vendimi, pushojnë së qenuri mjet ligjor për pagesë, nga data 15 maj i vitit 2018.

3. Kartëmonedhat nga paragrafi 1 i këtij vendimi do të këmbehen nga data 15 maj i vitit 2018 deri më datë 15 maj të vitit 2019.

Këmbimi do të bëhet nga bankat e themeluara në Republikën e Maqedonisë.

4. Nga data 16 maj i vitit 2019, këmbimi i kartëmonedhave nga paragrafi 1 i këtij vendimi do të kryhet në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë.

5. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e shpalljes në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe do të zbatohet nga data 15 maj i vitit 2018.

Nr.V.02-15/VI-5/2018
29 mars viti 2018
Shkup

Guvernator dhe Kryetar
i Këshillit të Bankës Popullore
të Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov